



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА
МАКЕДОНИЈА



Në bazë të nenit 22 paragrafi 7 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) dhe nenit 40 paragrafi 2 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit nga parashtrues i panjohur me pohime për ekzistim të konfliktit të interesit, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në seancën e 54-të, vazhdimi i par i mbajtur me datë 02.11.2021 morri,

VENDIM

Denoncimi për fillimin e procedurës për përcaktimin e gjendjes së konfliktit të interesave me nr. 09-32/1 nga 04.01.2021 e dorëzuar nga parashtrues i panjohur, REFUZOHET

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit nuk ka elemente për veprim kompetent në lëndën me numër 09-32/1 të datës 04.01.2021.

Lënda me numër 09-32/1 të datës 04.01.2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Arsyetim

Çështja numër 09-32/1 e datës 04.01.2021 është formuar në bazë të kallëzimit të një parashtruesi të panjohur kundër ///, me pretendime për nepotizëm dhe konflikt interesi për faktin se në shpallje janë paraqitur fëmijë të gjyqtarëve, prokurorëve publikë, anëtarët e këshillit gjyqësor, kryetarët e gjykatave dhe politikanët aktualë, fakti që komisioni për dhënien e provimit pranues ka gjyqtarë dhe prokurorë kolegë të kandidatëve aktualë.

Pas shqyrtimit të aplikacionit, KSHPK-ja konstaton se në këtë rast nuk ka asnjë mënyrë për të konfirmuar ndikimin e dhënies së provimit pranues në Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë.

Në seancën e mbajtur më 2 nëntor 2021, KSHPK-ja ka konstatuar se nuk ka juridiksion për të vazhduar më tej në këtë rast, sepse nuk ka asnjë mënyrë për të konfirmuar ndikimin e dhënies së provimit pranues në Akademinë për gjyqtarë dhe Prokurorë publikë.

Duke pasur parasysh të theksuarën më sipër, Komisioni Shtetëror nuk ka elemente për veprime kompetente, prandaj u vendos si në dispozitën e këtij vendimi.

**KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT**
Kryetar,
Biljana Ivanovska

Sipas përfundimit të KSHPK-së,
Punoi: EM, Këshilltar
Miratoi: K.N, anëtar i KSHPK - së

